REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË
UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË
REKTORATI
Nr. / Br. / No. 2864 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 9
Data / Datum / Date 03/10/2023 Pejë / Peć

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

**Senati** Pejë, më 27.09.2023

Mbështetur në kompetencat e përcaktuara me nenin 48, nenin 167, nenin 169 dhe nenin 170, të Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, Nr. 04-V-622, 2013, Statutit të Institutit për Shkencë dhe Arte, Nr. 249/23 të dt. 07.02.2023, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Arsimin e Lartë Nr.04/L-037, Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr.07/2017, dt. 19.10.2017, për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr. 01/2018 parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension, dhe Udhëzimi Administrativ për plotësimin dhe precizimin - (aneksi - I - MASHT) 7/2018 e UA Nr.01/2018 parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension, Senati i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, më datë 27.09.2023, miraton këtë:

# RREGULLORE PËR EMËRIM – RIEMËRIM DHE PROCEDURAT E REKRUTIMIT TË PERSONELIT NË INSTITUTIN PËR SHKENCË DHE ARTE

## Neni 1
## Qëllimi

Qëllim i kësaj rregulloreje është përcaktimi i procedurave vlerësuese dhe përzgjedhëse lidhur me emërim-riemërim dhe procedurat e rekrutimit të personelit të rregullt të Institutit për Shkencë dhe Arte (në tekstin e mëtejmë: "ISHA"), duke përfshirë kategoritë e parapara me dispozitat ligjore në fuqi.

## Neni 2
## Fushëveprimi

Kjo Rregullore zbatohet ndaj personelit të ISHA-së që i nënshtrohen procedurave vlerësuese dhe përzgjedhëse për emërim dhe riemërim.

## Neni 3
## Personeli i ISHA

Personeli i ISHA përbëhet nga: Bashkëpunëtor shkencor; Bashkëpunëtor i lartë shkencor; Këshilltar shkencor; Hulumtuesi; Hulumtues i pavarur.

**Kushtet dhe kriteret për titujt shkencor**

**Neni 4**
**Titulli "Bashkëpunëtor shkencor"**

1. Për titullin **Bashkëpunëtor shkencor**, kandidati duhet të plotësoj kriteret si në vijim:
   1.1. Të ketë gradën e doktorit të shkencës;
   1.2. Të tregojë aftësi për kërkime shkencore;
   1.3. Të ketë së paku 1 punim shkencor të publikuara në revista shkencore ndërkombëtare të indeksuar në platformat me recension ndërkombëtar **(Web of Science dhe Scopus)**, si autor i parë ose korrespondent.
   1.4. Të ketë pjesëmarrje aktive në konferenca shkencore ndërkombëtare;
   1.5. Të ketë së paku tre (3) vite përvojë pune në procesin e kërkimeve shkencore dhe projekte kërkimore.
2. Botimet duhet të jenë nga fusha e ekspertizës së kandidatit, nga fusha relevante ose fusha që kandidati mbulon në procesin e kërkimeve shkencore;
3. Emërimi për titullin **Bashkëpunëtor shkencor**, si dhe kohëzgjatja e punësimit është për katër (4) vite.

**Neni 5**
**Titulli "Bashkëpunëtor i lartë shkencor"**

1. Për titullin **Bashkëpunëtor i lartë shkencor**, kandidati duhet të plotësoj kriteret si në vijim:
   1.1. Të ketë thirrjen e doktorit të shkencës nga lëmia përkatëse;
   1.2. Të tregojë aftësi për kërkime shkencore;
   1.3. Të ketë së paku 3 punime shkencore të publikuara në revista shkencore ndërkombëtare të indeksuara në platformat me recension ndërkombëtar **(Web of Science dhe Scopus)**, si autor i parë ose korrespondent.
   1.4. Të dëshmojë punë, dije dhe mjeshtri në hartimin e projekteve kërkimore-shkencore.
2. Botimet duhet të jenë nga fusha e ekspertizës së kandidatit, nga fusha relevante ose fusha që kandidati mbulon në procesin e kërkimeve shkencore.
3. Emërimi për titullin **Bashkëpunëtor i lartë shkencor**, si dhe kohëzgjatja e punësimit është për katër (4) vite.

**Neni 6**
**Titulli "Këshilltar shkencor"**

1. Për titullin **Këshilltar shkencor**, kandidati duhet të plotësoj kriteret si në vijim:
   1.1. Të ketë gradën e doktorit të shkencës;
   1.2. Të ketë arritur një shkallë të lartë të pjekurisë shkencore që dëshmohet nëpërmjet veprave të botuara me rëndësi të veçantë për Institutin me të cilën merret;

1.3. Të ketë së paku 5 punime shkencore të publikuara në revista shkencore ndërkombëtare të indeksuara në platformat me recension ndërkombëtar **(Web of Science dhe Scopus)**, si autor i parë ose korrespondent;
1.4. Përvojë afatgjatë në projekte të kërkimeve themelore dhe të aplikueshme;
1.5. Të ofrojë dëshmi për udhëheqjen e së paku 1 projekti kërkimor-shkencor.

2. Botimet dhe projektet duhet të jenë nga fusha e ekspertizës së kandidatit, nga fusha relevante ose fusha që kandidati mbulon në procesin e kërkimeve shkencore dhe projekteve kërkimore.
3. Emërimi për titullin **Këshilltar shkencor**, si dhe kohëzgjatja e punësimit bëhet për kohë të pacaktuar.

**Kushtet dhe kriteret për titujt hulumtues**

**Neni 7**
**Titulli "Hulumtuesi"**

1. Për titullin **Hulumtuesi**, kandidati duhet të plotësoj kriteret si në vijim:
   1.1. Të ketë kryer fakultetin në nivelin bachelor;
   1.2. Të ketë të regjistruar studimet postdiplomike;
   1.3. Të ketë punime profesionale e shkencore të botuara në platforma të indeksuara;
   1.4. Të ketë notën mesatare në studimet themelore jo më pak se tetë (8);
2. Emërimi për titullin **Hulumtuesi**, si dhe kohëzgjatja e punësimit është për tri (3) vite.

**Neni 8**
**Titulli "Hulumtues i pavarur"**

1. Për titullin **"Hulumtues i pavarur"**, kandidati duhet të plotësoj kriteret si në vijim:
   1.1. Të ketë të përfunduar studimet postdiplomike;
   1.2. Të ketë të publikuara punime profesionale-shkencore në platforma të indeksuara;
   1.3. Të ketë notën mesatare në studimet themelore dhe postdiplomike jo më pak se tetë (8);
   1.4. Të ketë njohuri elementare në fushën e kërkimeve shkencore dhe hartimin e projekteve.
2. Emërimi për titullin **Hulumtuesi**, si dhe kohëzgjatja e punësimit është për tri (3) vite.

**Neni 9**
**Kohëzgjatja e emërimit dhe kufizimet për emërim**

1. Afatet kohore për të cilat bëhet zgjedhja përcaktohen në Ligjin për veprimtarinë kërkimore shkencore dhe në këtë rregullore.
2. Kontrata për një periudhë të caktuar që ripërtërihet në mënyrë të qartë ose të vetëkuptueshme për një periudhë të punësimit më të gjatë se dhjetë (10) vite, konsiderohet si kontratë për një periudhë të pacaktuar kohore.
3. Në ISHA nuk lejohet rekrutimi i personelit që konsiderohet person i afërt[1] brenda ISHA (në relacionin bashkëshortor, prind-fëmijë, vëlla-motër, motër-motër, vëlla-vëlla dhe anasjelltas).
4. Shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi në Republikën e Kosovës themelojnë marrëdhënie pune sipas Ligjit të Punës, nën kushtet dhe kriteret e përcaktuara me ligj të veçantë për punësimin e shtetasve të huaj dhe sipas konventave ndërkombëtare.

**Neni 10**
**Procedurat e konkursit për rekrutimin dhe avancimin e personelit në ISHA**

1. Procedura përzgjedhëse për emërim-riemërim dhe avancim do të bëhet në mënyrë transparente dhe me shpalljen e konkursit publik për pozitën. Konkursi për riemërim dhe avancim është proces i brendshëm në kuptimin e Ligjit për Punë në Kosovë.
2. Konkursi për emërim, riemërim dhe avancim shpallet nga Senati i UHZ-së, sipas propozimit të Këshillit Drejtues, varësisht prej nevojave të ISHA-së.
3. ISHA mund të kërkojë shpalljen në konkurs të pozitave të cilat lidhen me personelin e rregullt të cilit i kanë mbetur më pak se 12 muaj deri në pension.
4. Personeli në marrëdhënie të rregullt pune sipas paragrafit 3 të këtij neni, nuk ka të drejtë të aplikoj në konkurs meqë të njëjtit, me vendim e drejtorit, i vazhdohet kontrata për periudhën e mbetur deri në pension.
5. Personelit të zgjedhur për pozitat sipas paragrafit 3 të këtij neni, i lëshohet kontrata e punës valide pas pensionimit të personelit përkatës të rregullt në ato pozita.
6. Propozimet e tij Këshilli Drejtues duhet t'i bazojë në nevojat reale, numrin e mjaftueshëm të kërkimeve që duhet të ketë një vend pune, për tu zgjedhur në thirrjen e shkencore apo hulumtuese.
7. Propozimet për pozita të reja me normë të plotë mund të merren parasysh nëse Këshilli drejtues ofron dëshmi që për atë pozitë ekziston nevoja:
8. Drejtori, me një arsyetim të bazuar, mund të vendosë t'i propozoj Senatit shpalljen e konkursit për vende të lira për personelin shkencor apo hulumtues, edhe nëse pozita nuk është paraparë me propozimin e Këshillit drejtues.

---

[1] Neni 3, pika 1.6 e ligjit nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

9. Konkursi duhet të përmbajë referencën te nenet përkatëse për zgjedhje në thirrje akademike të Statutit të ISHA-së dhe këtë Rregullore.
10. Konkursi shpallet në ueb-faqen e UHZ-së, media të shkruara dhe elektronike. Kohëzgjatja e konkursit është pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike.
11. Punëdhënësi në sektorin publik, është i detyruar që një kopje të shpalljes së konkursit publik ta dërgojë në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës (MPMS)
12. Aplikantët duhet të dorëzojnë dokumentet e nevojshme në formë të shtypur dhe në formë elektronike.
13. Dokumentacioni i shtypur duhet të dorëzohet në Rektorat, në Zyrën e Protokollit, ku aplikanti duhet të pajiset me numër të aplikimit dhe konfirmimit të dorëzimit të dokumentacionit sipas kushteve të publikuara, kurse versioni elektronik dërgohet paraprakisht në adresën zyrtare të Universitetit të Pejës (apliko.online@unhz.eu).
14. Pas mbylljes së konkursit, zyra e protokollit harton një raport me shkrim në të cilin përfshihen të dhënat për kandidatët të cilët kanë aplikuar, pozitat për të cilat kanë aplikuar, dhe këtë raport e dorëzojnë në Rektoratin e Universitetit (Departamenti për Mësimdhënie, Çështje Studentore dhe Kërkimore Shkencore).

**Neni 11**

**Njohja e thirrjeve të fituara në ISHA**

Senati i Universitetit, sipas propozimit të njësive akademike dhe aprovimit të Këshillit drejtues të ISHA-së, mund t'i njoh thirrjet e fituara në ISHA dhe personelin të angazhojë apo transferojë si personel akademik, varësisht prej kushteve që i plotëson, konform kësaj rregulloreje dhe Ligjit për Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore në thirrjen akademike përkatëse.

**Neni 12**

**Komisionet vlerësuese**

1. Këshilli shkencor është i obliguar që për çdo pozitë të shpallur në Konkurs të caktojë komisionin vlerësues.
2. Më së largu tri (3) ditë pas mbylljes së konkursit, kryesuesi i Këshillit shkencor thërret mbledhjen e këshillit shkencor në të cilën merret vendimi për themelimin e komisioneve vlerësuese dhe komisionit të ankesave për konkurs në përbërje prej 3 anëtarëve.
3. Komisionet vlerësuese janë organe me besueshmëri të lartë profesionale, akademike dhe etike, të cilat përbëhen prej tre (3) anëtarëve. Askush nuk ka të drejt të ndërhyje në kompetencat menaxhuese të procesit të vlerësimit të komisioneve vlerësuese. Çdo ndërhyrje gjatë vlerësimit do të konsiderohet si shkelje ligjore, disiplinore dhe etike dhe e cila duhet të raportohet në organet e UHZ.
4. Komisioni vlerësues propozohet nga radhët e profesorëve të UHZ-së.

5. Në komisione vlerësuese duhet të jenë së paku dy (2) anëtarë nga fusha e ngushtë me pozitën për të cilën është shpallur konkursi. Vendimit për themelimin e komisionit i bashkëngjiten Vendimet për thirrjet akademike/shkencore të anëtarëve të Komisioneve Vlerësuese, që duhet të jenë në gjuhën shqipe po ashtu.
6. Komisioni vlerësues është i obliguar që gjatë punës së tij të respektojë dispozitat e Ligjit për veprimtarinë kërkimore-shkencore, Statutin e Universitetit "Haxhi Zeka", Statutin e ISHA-së, këtë Rregullore dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.
7. Anëtarët e komisionit vlerësues duhet të kenë thirrje më të lartë akademike të barazëvlefshme me thirrje shkencore ose së paku të njëjtë me pozitën për të cilën duhet të shkruhet vlerësimi.
8. Në mungesë të numrit të mjaftueshëm të profesorëve si në paragrafin 4, 5 dhe 7 të këtij neni, në përbërje të komisionit vlerësues mund të emërohen edhe profesorë nga universitetet brenda dhe jashtë vendit.
9. Në mungesë të anëtarëve në marrëdhënie të rregullt pune si në paragrafin 4, 5, 7 dhe 8, anëtarë të komisionit vlerësues mund të jenë edhe personat e pensionuar që kanë thirrjet e nevojshme akademike nga lëmi përkatës dhe të cilët nuk e kanë kaluar moshën 70 vjeçare, përjashtimisht profesorëve emeritus të cilët kanë kontratë për mbajtjen e mësimit dhe mbi këtë moshë.
10. Drejtori i ISHA-së duhet t'i ofrojë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm komisionit vlerësues dhe po ashtu, me kërkesë të komisionit vlerësues duhet të krijojnë kushte infrastrukturore dhe logjistike për punën më të lehtë të komisionit.
11. Kryetari i komisionit vlerësues është i obliguar që të thërras anëtarët e tjerë të komisionit dhe të hartojnë raportin e vlerësimit.
12. Komisioni vlerësues është i obliguar që në afat prej dhjetë (10) ditëve nga dita e emërimit të dorëzoj raportin e vlerësimit për kandidatët të cilët kanë aplikuar për pozitën e caktuar.
13. Këshilli shkencor ka të drejtë të ndryshojë përbërjen e komisionit vlerësues përkatësisht të formoj komisionin e ri nëse konstatohet se komisioni i parë nuk ka respektuar afatet e parapara në këtë rregullore. Ky ndryshim duhet të ndodh menjëherë apo një ditë pas afatit të caktuar si në pikën 12 të këtij neni.
14. Pas ndryshimit të përbërjes së komisionit vlerësues, Këshilli i fakultetit i jep afat komisionit edhe pesë (5) ditë shtesë që të hartojë dhe ta dorëzojë raportin për kandidatët e paraqitur në konkurs.
15. Komisioni vlerësues është i obliguar që t'u japë përparësi kandidatëve të cilët kanë kritere dhe kualitete më të larta në krahasim me kandidatët e tjerë, dhe të arsyetojë rekomandimin e bërë.
16. Në raportin e komisionit vlerësues duhet të bëhet i qartë propozimi për emërimin, riemërimin dhe avancimin e kandidatëve të kërkuar me konkurs dhe të dallohet nga propozimi për kandidatët të cilët nuk janë emëruar, riemëruar apo avancuar.
17. Pas hartimit dhe nënshkrimit të raportit nga tre (3) anëtarët, kryetari i komisionit vlerësues është i obliguar që ta dorëzojë raportin në Këshillin shkencor. Në raste të veçanta pranohet nënshkrimi elektronik, mirëpo Zyra për çështje akademike

rezervon të drejtën të konfirmoj nënshkrimin elektronik me anëtarin përkatës të komisionit.

18. Anëtarët e komisionit vlerësues mbajnë përgjegjësi ligjore, disiplinore dhe etike për vërtetësinë e të dhënave të shënuara në raportin e vlerësimit dhe për rekomandimet që bëjnë, sipas kodit të etikës dhe dispozitave të tjera ligjore në fuqi.

**Neni 13**
**Procedura pas dorëzimit të raportit nga Komisioni Vlerësues**

1. Këshilli shkencor, pas pranimit të raportit nga komisioni vlerësues, është i obliguar që në mbledhjen e radhës (jo më vonë se 5 ditë) të shqyrtojë raportin dhe të konstatojë respektimin e procedurave dhe përmbushjen e obligimeve në lidhje me raportin e komisionit vlerësues.
2. Këshilli shkencor, pas mbajtjes së mbledhjes dhe konstatimit të gjendjes së raporteve vlerësuese, brenda dy (2) ditëve i përcjell raportet vlerësuese në versionin elektronik dhe kopjet fizike pranë Departamentit për Mësimdhënie, Çështje Studentore dhe Kërkime Shkencore të UHZ-së.
3. Departamenti për Mësimdhënie, Çështje Studentore dhe Kërkime Shkencore i UHZ-së është i obliguar që brenda pesë (5) ditëve të punës pas marrjes së raporteve vlerësuese nga ana e Këshillave të fakulteteve, të hartojë buletinët dhe të njëjtit t'i publikoj në ueb faqen e UHZ-së.
4. Departamenti për Mësimdhënie, Çështje Studentore dhe Kërkime Shkencore, përkatësisht personeli i autorizuar, nëse konstaton se ndonjë nga raportet e dorëzuara nga Këshilli i fakultetit përkatës nuk është në rregull me dokumentacionin, atëherë duhet të kërkojë nga Prorektori për mësim që ta obligoj fakultetin përkatës që të kompletoj dokumentacionin para se të dalë në Buletin.
5. Buletinët duhet të qëndrojnë të publikuara në ueb faqe të UHZ-së në kohëzgjatje dhjetë (10) ditëve kalendarike nga dita e parë e publikimit.
6. Gjatë fazës së publikimit të raporteve të komisioneve vlerësuese në Buletinë, kandidatët e pakënaqur kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë në Këshillin e fakultetit përkatës.
7. Ankesat eventuale të kandidatëve duhet të dorëzohen në Këshillin shkencor.
8. Këshilli shkencor është i obliguar që pas kalimit të afatit të Buletinit, në afat më së largu prej shtatë (7) ditëve, të vlerësoj raportet e komisioneve vlerësuese dhe të vendosë për miratimin ose jo të atyre raporteve.
9. Gjatë shqyrtimit të raporteve, Këshilli shkencor është i obliguar që të shqyrtojë edhe ankesat e kandidatëve të cilët kanë parashtruar ankesë brenda afatit ligjor, (gjatë kohës që Buletinët janë të publikuar) dhe ndaj ankesave të jap përgjigje me shkrim.
10. Këshilli shkencor është i obliguar që pas shqyrtimit dhe miratimit ose jo të raporteve të komisioneve vlerësuese, vendimin përkatës dhe detajet e tjera rreth shqyrtimit të ankesave t'i dorëzojë brenda tre (3) ditëve pranë

Departamenti për Mësimdhënie, Çështje Studentore dhe Kërkime Shkencore të UHZ-së.

11. Zyra për çështje akademike ose zyrtari i autorizuar, nëse konstaton se ka ndonjë lëshim në materialin e dorëzuar nga Këshilli shkencor, është e obliguar që ta informojë Drejtorin e ISHA-së.

**Neni 14**

**Shqyrtimi i propozimeve të Këshillit shkencor për emërim-riemërim dhe avancimin e personelit nga Senat**

1. Në një afat prej njëzetë e pesëmbëdhjetë (15) ditësh pas pranimit të propozimeve të Këshillit shkencor, Departamenti për Mësimdhënie, Çështje Studentore dhe Kërkime Shkencore përgatitë për Senat pasqyrat me propozimet përkatëse: propozimin e Komisionit Vlerësues, Këshillit shkencor.
2. Propozimet e këshillit shkencor për emërimin, riemërimin ose avancimin e personelit të ISHA-së shqyrtohen nga senati i UHZ-së.
3. Vendimi i Senatit lidhur me propozimet e cekura në pikën 1 të këtij neni, merret më së largu njëzet (20) ditë pas përgatitjes së pasqyrave nga Departamenti për Mësimdhënie, Çështje Studentore dhe Kërkime Shkencore.
4. Nëse Senati vendos ta refuzojë propozimin e Këshillit shkencor, lënda përkatëse brenda dy (2) ditëve kthehet për rishqyrtim në Këshillin shkencor.
5. Këshilli shkencor obligohet që brenda shtatë (7) ditësh pas pranimit të vendimit të Senatit të rishqyrtoj lëndët për rivlerësim dhe vendimin përkatës ta dorëzoj brenda tri (3) ditëve pranë Departamentit për Mësimdhënie, Çështje Studentore dhe Kërkime Shkencore të UHZ-së.
6. Nëse Këshilli shkencor, edhe pas rishqyrtimit sjell të njëjtin propozim, Senati në një afat jo më të gjatë se njëzet (20) ditë nga pranimi i tyre, merr vendimin përfundimtar.
7. Për raste të veçanta para arritjes së propozimit në Senat, me kërkesë të Drejtorit afati i të gjithë procedurës mund të zgjatet, dhe maksimumi është 30 ditë.

**Neni 15**

**Vendimi, periudha e ankimimit dhe kohëzgjatja e konkursit**

1. Procedura e votimit në Senat për propozimet e Këshillit shkencor lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit të ISHA-së bëhet sipas Rregullores së Punës të Senatit.
2. Në rast se anëtari i personelit shkencor/hulumtues nuk i fiton votat e nevojshme për avancim, atëherë Senati voton për riemërim në thirrjen ekzistuese.
3. Ndaj vendimit të Senatit në afat jo më larg se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas pranimit të vendimit, mund të bëhet ankesë në Komisionin për ankesa dhe parashtresa në kuadër të Senatit të UHZ - së, që shërben si instancë e parë dhe e fundit e ankimimit në UHZ.

4. Konkursi për emërim, riemërim ose avancim të personelit akademik, duhet të përmbyllet me vendime përkatëse të Senatit të UHZ-së për të gjitha vendet e shpallura, në një periudhë jo më të gjatë se 175 ditë nga dita e shpalljes.

**Neni 16**
**Hyrje në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga senati.

Kryesuesi i Senatit
Prof. dr. Armand Krasniqi

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË
UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË
REKTORATI
Nr. / Br. / No. 2864 Nr. i faq/ Br. str / No. pg. 9
Data / Datum / Date: 03.10.2023 Pejë / Peć

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Based on the competencies defined in Article 48, Article 167, Article 169, and Article 170, of the Statute of the "Haxhi Zeka" University in Peja, No. 04-V-622, 2013, the Statute of the Institute for Science and Arts, No. 249/23 dated 07.02.2023, in accordance with the provisions of the Law on Higher Education No. 04/L-037, Labor Law No. 03/L-212, Administrative Instruction (MPMS) No. 07/2017, dated 19.10.2017, regarding the regulation of competition procedures in the public sector, Administrative Instruction (MASHT) No. 01/2018 principles for the recognition of international platforms and journals with review, and the Administrative Instruction for supplementation and precision - (Annex - I - MASHT) 7/2018 and UA No.01/2018 principles for the recognition of international platforms and journals with review, the Senate of the "Haxhi Zeka" University in Peja, on the date 27.09.2023, adopts this:

# REGULATION FOR APPOINTMENT – REAPPOINTMENT AND RECRUITMENT PROCEDURES OF STAFF IN THE INSTITUTE FOR SCIENCE AND ARTS

## Article 1

## Purpose

The purpose of this regulation is to define the evaluative and selective procedures related to appointment-reappointment and the recruitment procedures of regular staff at the Institute for Science and Arts (in the following text: "ISHA"), including the categories provided by current legal provisions.

## Article 2

## Scope

This Regulation applies to the staff of ISHA who are subject to evaluative and selective procedures for appointment and reappointment.

## Article 3

## ISHA Staff

The staff of ISHA consists of: Research Associate; Senior Research Associate; Scientific Advisor; Researcher; Independent Researcher.

## Conditions and Criteria for Scientific Titles

## Article 4

## Title "Research Associate"

1. For the title of Research Associate, the candidate must meet the following criteria:
   1.1. Must hold a Doctor of Science degree;
   1.2. Must demonstrate ability for scientific research;
   1.3. Must have at least 1 scientific paper published in international scientific journals indexed in international review platforms (Web of Science and Scopus), as the first author or correspondent.
   1.4. Must have active participation in international scientific conferences;
   1.5. Must have at least three (3) years of work experience in scientific research and research projects.
2. Publications must be from the candidate's field of expertise, relevant field, or the field the candidate covers in the research process;
3. The appointment to the title of Research Associate, as well as the duration of employment, is for four (4) years.

## Article 5

## Title "Senior Research Associate"

1. For the title of Senior Research Associate, the candidate must meet the following criteria:
   1.1. Must hold a Doctor of Science degree in the respective field;
   1.2. Must demonstrate ability for scientific research;
   1.3. Must have at least 3 scientific papers published in international scientific journals indexed in international review platforms (Web of Science and Scopus), as the first author or correspondent.
   1.4. Must demonstrate work, knowledge, and expertise in drafting scientific-research projects.
2. Publications must be from the candidate's field of expertise, relevant field, or the field the candidate covers in the research process.

3. The appointment to the title of Senior Research Associate, as well as the duration of employment, is for four (4) years.

**Article 6**

**Title "Scientific Advisor"**

1. For the title of Scientific Advisor, the candidate must meet the following criteria:

   1.1. Must hold a Doctor of Science degree;

   1.2. Must have achieved a high level of scientific maturity as evidenced through published works of significant importance for the Institute;

   1.3. Must have at least 5 scientific papers published in international scientific journals indexed in international review platforms (Web of Science and Scopus), as the first author or correspondent;

   1.4. Long-term experience in fundamental and applied research projects;

   1.5. Must provide evidence of leading at least 1 scientific research project.

2. Publications and projects must be from the candidate's field of expertise, relevant field, or the field the candidate covers in the research process and research projects.

3. The appointment to the title of Scientific Advisor, as well as the duration of employment, is for an indefinite period.

**Conditions and Criteria for Research Titles**

**Article 7**

**Title "Researcher"**

1. For the title of Researcher, the candidate must meet the following criteria:

   1.1. Must have completed undergraduate studies;

   1.2. Must be enrolled in postgraduate studies;

   1.3. Must have professional and scientific works published on indexed platforms;

   1.4. Must have an average grade in bachellor studies of no less than eight (8);

2. The appointment to the title of Researcher, as well as the duration of employment, is for three (3) years.

**Article 8**

**Title "Independent Researcher"**

1. For the title "Independent Researcher", the candidate must meet the following criteria:

   1.1. Must have completed postgraduate studies;

   1.2. Must have professional-scientific works published on indexed platforms;

1.3. Must have an average grade in bachellor and postgraduate studies of no less than eight (8);

1.4. Must have basic knowledge in the field of scientific research and project drafting.

2. The appointment to the title of Researcher, as well as the duration of employment, is for three (3) years.

**Article 9**

**Duration of Appointment and Limitations for Appointment**

1. The time periods for which selections are made are determined in the Law on Scientific Research Activities and in this regulation.

2. A fixed-term contract that is clearly or implicitly renewed for a period of employment longer than ten (10) years is considered an indefinite term contract.

3. In ISHA, the recruitment of personnel considered as a close relative within ISHA (in the marital, parent-child, brother-sister, sister-sister, brother-brother relationship, and vice versa) is not permitted.

4. Foreign nationals and stateless persons in the Republic of Kosovo establish employment relationships according to the Labor Law, under the conditions and criteria determined by a special law for the employment of foreign nationals and according to international conventions.

**Article 10**

**Recruitment and Advancement Procedures for Personnel in ISHA**

1. The selection procedure for appointment-reappointment and advancement will be conducted transparently and with the announcement of a public call for the position. The competition for reappointment and advancement is an internal process within the meaning of the Labor Law in Kosovo.

2. The call for vacancy for appointment, reappointment, and advancement is announced by the Senate of UHZ, based on the proposal of the Governing Council, depending on the needs of ISHA.

3. ISHA may request the announcement of a call for positions related to the regular personnel who have less than 12 months remaining until retirement.

4. Regular employment personnel under paragraph 3 of this article, are not entitled to apply in the call as the same, by decision of the director, may have their contract extended for the remaining period until retirement.

5. The personnel selected for positions according to paragraph 3 of this article, are issued a valid employment contract after the retirement of the respective regular personnel in those positions.

6. Its Governing Council must base its proposals on real needs, a sufficient number of researches that a job position must have, to be selected in the scientific or research call.

7. Proposals for new full-time positions may be considered if the Governing Council provides evidence that there is a need for that position.

8. The director, with a reasoned justification, may propose to the Senate the announcement of a call for vacant positions for scientific or research personnel, even if the position is not foreseen in the proposal of the Governing Council.

9. The vacancy call must include a reference to the relevant articles for selection in the academic call of the ISHA Statute and this Regulation.

10. The vacancy call is announced and published on the website of UHZ, in written and electronic media. The duration of the call is fifteen (15) calendar days.

11. The public sector employer is obliged to send a copy of the public call announcement to the Employment Agency of the Republic of Kosovo (MPMS).

12. Applicants must submit the necessary documents in printed and electronic form.

13. The printed documentation must be submitted to the Rectorate, at the Protocol Office, where the applicant must be provided with an application number and confirmation of documentation submission according to the published conditions, while the electronic version is sent in advance to the official address of the University of Peja (apply.online@unhz.eu).

14. After the call closes, the protocol office compiles a written report including data on the candidates who have applied, the positions for which they have applied, and this report is submitted to the Rectorate of the University (Department of Teaching, Student Affairs, and Scientific Research).

**Article 11**

**Recognition of titles in ISHA**

The University Senate, based on the proposal of the academic units and the approval of the Governing Council of ISHA, may recognize the titles won in ISHA and engage or transfer personnel as academic staff, depending on the conditions they meet, in accordance with this regulation and the Law on Scientific Research Activities in the respective academic call.

**Article 12**

**Evaluation Commissions**

1. The scientific council is obliged to appoint an evaluation commission for each position announced in the call for vacancy.
2. No later than three (3) days after the call closes, the chairman of the scientific council convenes a meeting of the scientific council at which a decision is made to establish the evaluation commissions and the complaints commission for the competition, consisting of 3 members.
3. The evaluation commissions are organs of high professional, academic, and ethical trustworthiness, consisting of three (3) members. No one has the right to interfere in the managerial competencies of the evaluation commission process. Any interference during the evaluation will be considered a legal, disciplinary, and ethical violation and must be reported to the UHZ bodies.
4. The evaluation commission is proposed from among the professors of UHZ.
5. The evaluation commissions must have at least two (2) members from the narrow field for the position for which the competition is announced. The decision to establish the commission is accompanied by Decisions for academic/scientific calls of the members of the Evaluation Commissions, which must also be in the Albanian language.
6. The evaluation commission is obliged to respect the provisions of the Law on Scientific Research Activities, the Statute of the "Haxhi Zeka" University, the ISHA Statute, this Regulation, and other legal and sub-legal acts in force during its work.
7. Members of the evaluation commission must have a higher academic call equivalent to a scientific call or at least the same as the position for which the evaluation is to be written.
8. In the absence of a sufficient number of professors as in paragraphs 4, 5, and 7 of this article, professors from universities inside and outside the country may be appointed to the composition of the evaluation commission.
9. In the absence of members in regular employment as in paragraphs 4, 5, 7, and 8, retired persons who have the necessary academic calls from the respective field and who have not exceeded the age of 70 years, with the exception of emeritus professors who have a contract for teaching and over this age, may be members of the evaluation commission.
10. The director of ISHA must provide the evaluation commission with all the necessary documentation and also, at the request of the evaluation commission, must create infrastructural and logistical conditions for the easier work of the commission.
11. The chairman of the evaluation commission is obliged to call the other members of the commission and draft the evaluation report.
12. The evaluation commission is obliged to submit the evaluation report for the candidates who have applied for the specified position within ten (10) days from the day of appointment.

13. The scientific council has the right to change the composition of the respective evaluation commission or to form a new commission if it is found that the first commission did not respect the deadlines provided in this regulation. This change should occur immediately or one day after the deadline set as in point 12 of this article.

14. After changing the composition of the evaluation commission, the Faculty Council gives the commission an additional five (5) days to draft and submit the report for the candidates presented in the competition.

15. The evaluation commission is obliged to give priority to candidates who have higher criteria and qualities compared to other candidates and to justify the recommendation made.

16. The report of the evaluation commission must clearly propose the appointment, reappointment, and advancement of the candidates sought with the competition and distinguish it from the proposal for candidates who have not been appointed, reappointed, or advanced.

17. After drafting and signing the report by three (3) members, the chairman of the evaluation commission is obliged to submit the report to the Scientific Council. In special cases, electronic signature is accepted, however, the Office for Academic Affairs reserves the right to confirm the electronic signature with the respective member of the commission.

18. Members of the evaluation commission bear legal, disciplinary, and ethical responsibility for the accuracy of the data recorded in the evaluation report and for the recommendations they make, according to the code of ethics and other legal provisions in force.

## Article 13

### Procedure after the Submission of the Report by the Evaluation Commission

1. The scientific council, after receiving the report from the evaluation commission, is obliged to review the report in its next meeting (no later than 5 days) and to ascertain the respect of procedures and the fulfillment of obligations regarding the report of the evaluation commission.

2. The scientific council, after holding the meeting and ascertaining the status of the evaluation reports, within two (2) days sends the evaluation reports in electronic version and physical copies to the Department for Teaching, Student Affairs, and Scientific Research of UHZ.

3. The Department for Teaching, Student Affairs, and Scientific Research of UHZ is obliged to prepare bulletins within five (5) working days after receiving the evaluation reports from the faculty councils, and to publish them on the UHZ website.

4. The Department for Teaching, Student Affairs, and Scientific Research, or the authorized personnel, if they find that any of the reports submitted by the respective

faculty council are not in order with the documentation, should request the Vice-Rector for Teaching to oblige the respective faculty to complete the documentation before it appears in the Bulletin.

5. Bulletins must remain published on the UHZ website for ten (10) calendar days from the first day of publication.

6. During the publication phase of the evaluation commission reports in the Bulletins, dissatisfied candidates have the right to file a complaint to the respective faculty council.

7. Any candidate complaints must be submitted to the scientific council.

8. The scientific council is obliged, after the Bulletin period has passed, within a maximum of seven (7) days, to evaluate the reports of the evaluation commissions and to decide on the approval or non-approval of those reports.

9. During the examination of the reports, the scientific council is obliged to also review the complaints of candidates who have filed a complaint within the legal deadline (while the Bulletins are published) and to respond in writing to the complaints.

10. The scientific council is obliged, after examining and approving or not the reports of the evaluation commissions, to deliver the respective decision and other details about the examination of complaints within three (3) days to the Department for Teaching, Student Affairs, and Scientific Research of UHZ.

11. The Office for Academic Affairs or the authorized officer, if they find any omission in the material submitted by the scientific council, is obliged to inform the Director of ISHA.

## Article 14

## Review of Proposals from the Scientific Council for Appointment-Reappointment and Advancement of Personnel by the Senate

1. Within a period of fifteen (15) days after receiving the proposals from the scientific council, the Department for Teaching, Student Affairs, and Scientific Research prepares for the Senate summaries with the respective proposals: the proposal of the Evaluation Commission, Scientific Council.

2. Proposals of the scientific council for the appointment, reappointment, or advancement of ISHA personnel are examined by the senate of UHZ.

3. The Senate's decision regarding the proposals mentioned in point 1 of this article is made no later than twenty (20) days after the preparation of the summaries by the Department for Teaching, Student Affairs, and Scientific Research.

4. If the Senate decides to reject the proposal of the scientific council, the respective case is returned for review to the scientific council within two (2) days.

5. The scientific council is obliged to reexamine the cases for reevaluation within seven (7) days after receiving the Senate's decision and to deliver the respective decision within three (3) days to the Department for Teaching, Student Affairs, and Scientific Research of UHZ.
6. If the scientific council, even after reexamination, brings the same proposal, the Senate, within no more than twenty (20) days from their receipt, makes the final decision.
7. In special cases before the proposal reaches the Senate, at the request of the Director, the entire procedure period can be extended, and the maximum is 30 days.

## Article 15

## Decision, Appeal Period, and Duration of the Competition

1. The voting procedure in the Senate on the proposals of the scientific council regarding the appointment, reappointment, and advancement of ISHA personnel is conducted according to the Senate's Working Regulations.
2. If a member of the scientific/research personnel does not receive the necessary votes for advancement, then the Senate votes for reappointment in the existing call.
3. Against the decision of the Senate, no later than fifteen (15) days after receiving the decision, an appeal can be made to the Complaints and Appeals Commission within the Senate of UHZ, which serves as the first and final instance of appeal in UHZ.
4. The call for the appointment, reappointment, or advancement of academic personnel must be concluded with the respective decisions of the Senate of UHZ for all announced positions, within a period not longer than 175 days from the day of announcement.

## Article 16

## Entry into Force

This regulation enters into force on the day of its approval by the senate.

Chairman of the Senate

Prof. Dr. Armand Krasniqi